Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE (KASH)

vleresuar për vitin 2027 - 2029

Prill, 2026

PËRMBAJTJA

1. MISIONI DHE VIZIONI I ARRU 2

1.1 PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ARRU-SË 2

2. SITUATA AKTUALE 3

3. OBJEKTIVAT E AUTORITETIT RREGULLATOR TË UJIT (ARRU) 3

4. KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE (KASH) 3

1. MISIONI DHE VIZIONI I ARRU

Autoriteti Rregullator i Ujit (ARRU), si autoritet i pavarur rregullator për shërbimet e ujit, ka përgjegjësi të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efiçente dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë. ARRU ka të definuar misionin e saj si në vijim:

Definimi i misionit:
"Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme për konsumatorët në tërë Kosovën, duke pasur parasysh mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e mjedisit''.

Bazuar në kornizën ligjore, ARRU përveç rregullimit të shërbimeve të ujit, ka për obligim të monitorojë që ato shërbime të ofrohen sipas standardeve. Në këtë kuptim vizioni i ARRU është definuar si:

Definimi i vizionit:

"Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë".

1.1 PËRGJEGJËSITË LIGJORE TË ARRU-SË

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka për detyrë rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë.

Përgjegjësitë kryesore të ARRU janë përshkruar si në vijim:

(i) Licencojë ofruesit e shërbimeve dhe të mbikëqyrë zbatimin e kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit në mënyrë që të mbrojë interesat e konsumatorëve dhe të sigurojë që tregu të zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe brenda kuadrit ligjor;

(ii) Përcaktojë tarifat e ofruesit të shërbimeve të ujit të pijshëm, ujërave të ndotur dhe ujit me shumicë, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;

(iii) Vendos standardet e shërbimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre nga ofruesit e shërbimeve të ujit;

(iv) Monitorojë performancën e KRU, duke i nxitur dhe inkurajuar për ngritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë operative dhe financiare;

(v) Zgjidhë ankesat e konsumatorëve, për të cilat konsumatori pretendon se ofruesi i shërbimit ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi;

(vi) Inspektojë përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe zbatimin e akteve ligjore të Autoritetit;

(vii) Hartojë dhe miratojë rregullore dhe vendime rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të Ligjit Nr. 05/L-042 dhe Ligjit Nr. 06/l -088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe ligjeve tjera të aplikueshme.

2. SITUATA AKTUALE

- Mbelueshmeria me rrjetin e ujësjellësit në nivel vendi: 79%
- Mbulueshmeria me kanalizim ne nivel vendi: 65%
- Humbjet e ujit në nivel vendi: 61%
- Cilesia e ujit te pijshëm ne nivel vendi (testet fiziko-kimike/ testet bakteriologjike): 97,4 / 98.7%

3. OBJEKTIVAT E AUTORITETIT RREGULLATOR TË UJIT (ARRU)

Objektivat që mëtohet të arrihen përmes Kornizës Afat-mesme të Shpenzimeve janë në harmoni me:

- Strategjinë Kombëtare Zhvillimore (SKZH) 2016-2021 dhe
- Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë (2017 – 2036)

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Zhvillim (SKZH), e miratuar nga Qeveria e Kosovës në janar të vitit 2016 për periudhën (2016-2021) nën

Nën **Masën 32. Shfrytëzimi racional dhe rritja e kapaciteteve të burimeve ujore** është listuar aktiviteti vijues:

- Aktiviteti 1. Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të kompanive rajonale të furnizimit me ujë, si dhe vendosja e ujëmatësve në të gjitha zonat e shërbimit me ujë.

Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë (2017 – 2036) promovon parimin e "shfrytëzimit racional të burimeve të ujit" dhe "zvogëlimin e humbjeve teknike dhe administrative të ujit" si në vijim. Në këtë Strategji

Nën **Masën 4.3: Forcimi i kapaciteteve institucionale** është listuar veprim vijues:

- Veprimi 4.3.5: Fuqizimi i ARRU për rregullimin e e trajtimit të ujërave të ndotura

Nën **Masën 8.14: Rritja e efiçiencës në shfrytëzimin e ujit** janë listuar veprimet vijuese:

- Veprimi 1.2.2: Zhvillimi i programeve për zbulimin dhe zvogëlimin e rrjedhjeve nga rrjetet e furnizimit me ujë
- Veprimi 1.3.2: Zvogëlimi i shfrytëzimit të paligjshëm të ujit të pijshëm

Tek të gjitha këto masa dhe aktivitete/ veprime ARRU është e ndërlidhur dhe jep kontributin e saj për sa i përket shfrytëzimit racional të burimeve të ujit, ripërtëritja e rrjetit të furnizimit me ujë dhe zvogëlimit të humbjeve të ujit (humbjet teknike dhe administrative).

4. KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE (KASH)

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, përveç shpenzimeve të zakonshme që i ka pasur në vitet paraprake, në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027, ka propozuar këto propozime për buxhet shtesë tek zëri i personelit dhe tek investimet kapitale.

1) ARRU i ka të aprovuara 21 pozita dhe të gjitha janë të plotësuara. Për vitin 2026-2028 ARRU planifikon rritjen e numrit të stafit me tri (3) pozita të reja: një pozitë është për Departamentin për Çështje Ligjore dhe Licenca, një pozitë është planifikuar për Departamentin e Tarifave dhe një pozitë për Njësinë e Inspektimit. Rritja e zonës së shërimit dhe futja në operim e impianteve kërkon resurse njerëzore të ARRU-së për t'u përballur me çështjet e trajtimit të ankesave, inspektimin e standardeve të shërbimit dhe përcaktimin e tarifave.

Arsyetim:

- Rritja e madhe e numrit të ankesave (për 36%) që arrijnë tek ARRU në vitet të fundit, pjesëmarrja në proceset gjyqësore është rritur për 47%, ka ndikuar në ngarkesën e ARRU-së për shqyrtim të ankesave dhe pjesëmarrje në seanca gjyqësore dhe zgjidhje të rasteve brenda afateve ligjore. Për të përballuar këtë fluks gjithnjë e në rritje të ankesave është i nevojshëm punësimi i 1 (një) juristi për të trajtuar ankesat e konsumatorëve.
- Departamenti i tarifave deri në vitin 2020 ishte i angazhuar kryesisht me përcaktimin e tarifave vetëm për shërbimet e ujit të pijshëm dhe për kanalizim. Që nga 2021 numër gjithnjë e më i madh i impianteve të përpunimit të ujërave të ndotur (IPUN) po futen në operim (tani janë 6 impiante në operim, për të cilat duhet të aplikohet një model krejt i ri dhe më kompleks i përcaktimit të tarifave. Përcaktimi i tarifave për ujëra të ndotur kërkon hulumtime dhe analiza më të detajuara për kostot që do të rrjedhin nga operimi i këtyre impianteve, po edhe verifikime në teren. Rrjedhimisht edhe departamenti i tarifave ka nevojë për 1 (një) të punësuar qoftë inxhinier ose economist që do të merret me të gjitha aspektet për përcaktimin e tarifave për IPUN.
- Edhe njësia e inspektimit ka qenë tejet e zënë me inspektimet e rregullta në teren (inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit, inspektimet tematike dhe inspektimet verifikuese). Për të shtuar prezencën në teren me qëllim inspektimin e aspekteve teknike dhe operative të ofruesve të shërbimeve në gjithë zonën e shërbimit ka shtruar domosdonë për 1 (një) inxhinier për të mbuluar aktivitetet e inspektimit në teren.

2) Zhvillimi i aplikacioni softuerik për procesim, ruajtje dhe arkivim të dhënave operacionale dhe financiare të ofruesve të shërbimeve. Aktualisht janë 4 departamente në ARRU që mbledhin të dhëna që prej vitit 2006 e këtej. Këto të dhëna ruhen nëpër databaza qoftë në Ecel apo Acces dhe janë të shpërndara. Departamenti i licencave mbledh dhe ruan të dhënat për kushtet e licencës dhe plotësimin e këtyre kushteve nga viti në vit, departamenti i tarifave ruan të dhënat e aplikacioneve tarifore, tarifat e zbatueshme dhe të plotësimit të caqeve tarifore, departamenti i performancës ruan të dhënat për treguesit kyç të performancës në baza tremujore dhe vjetore dhe njësia e inspektimi mbledh dhe rifreskon në baza vjetore të dhënat kyçe të infrastrukturës së ujit dhe ujërave të ndotur.

ARRU ka menduar të zhvillojë një aplikacion softuerik ku do të integroheshin të gjitha të dhënat në një databazë të vetme, ku ofruesit e shërbimeve do të mund të insertonin në mënyrë online të dhënat dhe publiku / konsumatorët do të mund të kishin qasje më të lehtë për t'u informuar rreth çështjeve me interes.

Tabela 1.Trendet e financimit 2024-2025 dhe vlerësimet 2026-2028

Autoriteti Rregullator per Sherbimet e Ujit	**2025 buxhetuar**	**2026 Vleresimi**	**2027 Vleresuar**	**2028 Vleresimi**	**2029 Vleresimi**
Total	415,977	504,426.00	443,426.00	451,627.00	468,458.00
Numri I punetoreve	21	21	23	24	24
Paga dhe Meditje	231,665	260,678	289,923.00	315,529.00	321,,260.00
Mallra dhe Sherbime	137,455	143,000.00	145,000	150,495.00	150,495.00
Shpenzime komunale	3,503.00	6,503.00	8,503.00	8,503.00	8,503.00
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale (zhvillimi i aplikacionit softuerik)	44,580.00				
Burimet e Financimit					
Grantet qeveritare	514,977	504,426.00	443,426.00	451,627.00	466,258.00
Te hyrat vetanake					
Financimet nga huamarrjet					
Grantet donatoret					

Tabela 2. Propozimet për politika të reja të cilat organizata buxhetore i ka përfshirë në Tabelën 1. (Vlerësimet 2026-2028)

Politika e re prioritare 1.	**Viti 2027 vlerësuar**	**Viti 2028 vlerësuar**	**Viti 2029 vlerësuar**
Përshkrimi : • Ngritja e Standardeve të Shërbimit • Avancimi i Politikave Tarifore • Avancimi i monitorimit dhe raportimit të performancës së ofruesve të shërbimeve, si dhe pjesamarja aktive në mekanizmat nga fusha e vlerësimit krahasues(bechmarkingut), në nivel global dhe rajonal • Kampanja- Informimin e konsumatorit për rolin dhe përgjegjësin e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit. • Zvoglimi i humbjeve të ujit.			
Ndërlidhja e politikës së re me Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme 2027-2029			
Viti	2027	2028	2029
Total	**443,426.00**	**443,627.00**	**464,258.00**
Numri i punëtorëve	23	24	24
Paga dhe mëditje	289,923	292,629.00	307,260.00
Mallra dhe shërbime	145,000.00	150,495.00	150,495.00
Shpenzime komunale	8,503.00	8,503.00	8,503.00
Subvencione dhe transfere			
Shpenzime kapitale			
Burimet e financimit			
Garantet qeveritare	443,426.00	445,627.00	466,258.00
Të hyrat vetanake	443,426.00	445,627.00	466,258.00
Financimet nga huamarrje			
Garantet nga Donatorët*			

Tabela 3. Parashikimi i të Hyrave Jo-tatimore të Organizates Buxhetore –ARRU te hyrat e veta i ka te planifikuara ne baze te buxhetit te aprovuar nga kuvendi i Kosoves.

Organizata Buxhetore:	**Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)**				
ARRU	Viti 2025 Arkëtimi	Viti 2026 Vlerësuar	Viti 2027 Vlerësuar	Viti 2028 Vlerësuar	2029 Vlerësuar
50401	519,765.00	504,426.00	441,426.00	466,427.00	468,458.00